



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government



Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova (UBKSK)

Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë (QKMP)

National Centre of Labour Medicine in Gjakova (NCLM)

Nacionalni Centar Medicine Rada u Đakovici (NCMR)

REPUBLIC OF KOSOVO
KOSOVES UNIVERZITETSKA BOLNIČKA
KLINIČKA SLUŽBA I HOSPITAL
NATIONAL CENTRE OF LABOUR MEDICINE
Nr. Presëbrej pres. 386
Data/Datum: 22.04.2025

Në bazë të nenit 79 (1), nenit 80, nenit 81 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zytarët Publikë, Rregullores Nr. 30/2024 për procedurën e Pranimi të Nënpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë, Njoftimit të Bordit Drejtues të SHSKUK me nr. prot. 364 të dt. 11.04.2025 dhe në bazë të detyrave dhe Përgjegjësi të Drejtorit Ekzekutiv sipas nenit 18 të Statutit të QKMP-së, U.D. i Drejtorit Ekzekutiv në QKMP shpallë:

KONKURS

Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës	Vende të lira	Koeficienti
Mjek Specialist i Mjekësisë së Punës	2	H8 - 12.5

Institucioni: Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë
Titulli i vendit të punës: Mjek Specialist i Mjekësisë së Punës (2 vende të lira)
Raporton tek: Drejtori Shëndetësor
Kohëzgjatja e kontratës: Për kohë të pacaktuar
Periudha provuese: Gjashtë muaj (180 ditë)
Koeficienti i pagës: H8-12.5
Orari i punës: 40 orë në javë
Nr. ref: 04/2025

Detyrat dhe përgjegjësitë e Mjekut Specialist të Punës:

- Planifikon, organizon dhe mbikqyrë punën mjekësore në Mjekësinë e Punës, vizitat sistematike dhe periodike të të punësuarve si dhe bën koordinimin e punëve të këtij Shërbimi me shërbimet tjera,
- Përshkruan, ordinon, përcjellë dhe kontrollon ecurinë e ekzaminimeve, kujdesit dhe mjekimit të të punësuarve
- Kryen vizita specialistike dhe ato sistematike për pacientet, përcakton (përpilon) programin e ekzaminimeve kliniko Laboratorike
- Përcakton aftësinë e ngelur të punës të të punësuarve gjatë ekspertizës duke u konsultuar me profile të tjera specialistike
- Plotëson dokumentacionin mjekësor shoqërues për të udhëzuar të punësuarit para komisionit invalidor me qëllim të përcaktimit të kategorisë së invaliditetit
- Më anë të aparaturës që posedon Shërbimi i Mjekësisë së Punës bëhet kontrollimi i kushteve të punës me burime të radioaktivitetit,
- Matjet dhe vlerësimi i rezultateve të ekzpozimit me rrezatim jonizues të personave të cilët punojnë me burime të rrezatimit jonizues
- Përcjellja, detektimi i pranisë dhe llojit të rrezatimit jonizues në ambient
- Matjet dhe vlerësimi i rezultateve të ekspozimit me rrezatim jonizues të pacienteve gjatë tretmaneve diagnostike
- Përcjellja dhe matjet e faktoreve të ndryshëm të dëmshëm për shëndetin në mënyrë të parandalimit të paraqitjes së sëmundjeve dhe invaliditetit të përkohëshëm ose të përhershëm
- Matja, përcjellja në kontiunitet dhe analiza e parametrave të mikroklimës së vendit të punës në këto fusha tematike:
temperatura, lagështia relative e ajrit, shtypja atmosferike e ajrit, shpejtësia e levizjes së ajrit, gazrat toksike, pluhuri dhe aerosolet, ndriçimi, zhurma dhe vibracioni, matja e rrezeve alfa, beta, gama dhe X si dhe matjen e Radonit radioaktiv në vendin e punës

- Rekomandon kur e sheh të arsyeshme dhe objektive ndërrimin e vendit të punës të të punësuarve gjegjësisht prekualifikimin e tyre me qëllim të ruajtjes së shëndetit dhe kohëzgjatjes së punës të punëtorëve të cilët punojnë në vendet e punës me kushte të posaçme të punës si dhe rekomandon rehabilitimin dhe eventualisht shërim të mëtejshëm në qendra mjekësore.
- Bashkpunimi me institucionet gjegjëse në vend dhe jasht vendit për avancim profesional me norma dhe standard ndërkombetare.
- Sigurimi i informacioneve të sakta të performances dhe raportimi për të gjitha fushat e përgjegjësisë, sigurimi i raporteve mujore për vizitat që ju bëhen të punësuarve
- Me ekipin e mesëm teknik të Mjekësisë së Punës koordinon punën gjatë matjes së mikroklimës, ajrëdojtjeve të mjedisit të punës dhe kushteve tjera të punës të cilat e shoqërojnë procesin tekniko-teknologjik
- Jep informacione mjekësore përsonave të interesuar, lëshon çertifikata mjekësore për aftësinë punuese, për patent shofer dhe udhëtime jashtë vendit, përcjellë dhe studion literaturën profesionale, angazhohet për aftësimin profesional duke rekomanduar aplikimin e të arriturave në mjekësi,
- Kryen edhe punë tjera të cilat i caktohen nga Drejtori Shëndetësor i Institucionit.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale, bazuar në specifikat e institucionit për pozicionin e Mjekut të Punës:

- Shkollimi universitar –Fakulteti i Mjekësisë në profilin e kërkuar (diploma kopje e noterizuar);
- Shkollimi Specialistik- Licenca e punës profesionale mjek specialist e vlefshme, e lëshuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës (kopje e noterizuar);
- Trajnime të realizuara në kuadër të veprimtarisë së Mjekësisë së Punës (preferohen)
- Njohuri për të punuar me kompjuter dhe mjete softueri (Word, Excel, ose të tjera).

Kriteret e përgjithshme për pranim për dy pozitat:

- Të jetë shtetasi Republikës së Kosovës (letënjoftimin kopje);
- Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje (vërtetim nga gjykata);
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vërtetim nga punëdhënësi);

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe plotësojnë kriteret e kërkuara me konkurs si dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurimit: Konkurimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar sipas këtij konkursi.

Data e mbylljes së Konkursit: Konkursi publikohet në SIMBNJ, në webfaqen e SHSKUK-se si dhe në tabelen e shpalljeve dhe dorëzimi i aplikacioneve është 30 ditë nga 22.04.2025 deri më 21.05.2025 ndërsa poashtu dorëzimi i aplikacioneve bëhet në të njëjten periudhë 22.04.2025 deri më 21.05.2025.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren online në web faqen e <https://shskuk.rks-gov.net/> të plotësohen në mënyrë elektronike (me kompjuter) dhe të dorëzohen në Sektorin e Burimeve Njerëzore në QKMP- Gjakovë.

Në aplikacion duhet të cekët qartë institucioni, titulli i vendit të punës dhe numri rendor i pozites. Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë profesionale t'i bashkëngjiten aplikacionit në kopje, dëshmitë për kandidatët që kanë kryer shkollimin jashtë Republikës së Kosovës, duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Vërejtje: Të gjitha njoftimet për procedurën e konkursit deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar bëhen përmes web faqes së SHSKUK, <https://shskuk.rks-gov.net>

Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë

Shpejtim Skivjani
U.D i Drejtorit Ekzekutiv





Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova (UBKSK)
Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)
Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë (QKMP)
National Centre of Labour Medicine in Gjakova (NCLM)
Nacionalni Centar Medicine Rada u Đakovici (NCMR)

KONKURS ZA RADNO MESTO

Institucija: Nacionalni centar za medicinu rada

Specijalista medicine rada: 2

Naziv radnog mesta: Specijalista medicine rada

Izveštava direktoru: Zdravstveni direktor

Trajanje ugovora: Na neodređeno vreme

Probni period: 6 meseci (180 dana)

Koeficijent plate: H8-12.5

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Broj referencije: 04/2025

Dužnosti i odgovornosti:

Planira, organizuje i nadgleda medicinsku praksu u oblasti medicine rada.

Vrši specijalističke i sistematske preglede pacijenata.

Određuje i kontroliše tok pregleda i lečenja zaposlenih.

Popunjava medicinsku dokumentaciju za upućivanje zaposlenih pred invalidsku komisiju.

Kontroliše uslove rada sa izvorima radioaktivnosti.

Merenje i procena izlaganja jonizujućem zračenju zaposlenih i pacijenata.

Praćenje i analiza parametara mikroklimе na radnom mestu.

Preporučuje promenu radnog mesta kako bi se obezbedilo zdravlje zaposlenih.

Izveštava o medicinskim aktivnostima i pruža tačne informacije u vezi sa radom službe.

Kvalifikacije i veštine: Univerzitetska diploma sa Medicinskog fakulteta u traženom profilu.

Licenca za specijalistu medicine rada izdata od Lekarske komore Kosova.

Treninzi realizovani u okviru medicine rada (poželjno).

Poznavanje rada na računaru i softverskih alata (Word, Excel, itd.).

Rok za prijavu i procedura: Rok za podnošenje prijava je [unesite datum roka za prijavu].

Za više informacija i prijavu, molimo vas da posetite zvanični veb sajt institucije ili da kontaktirate odgovarajući odeljak.

Opšti kriterijumi za prijem na radna mesta:

Kandidat treba da bude državljanin Republike Kosovo (kopija lične karte).

Kandidat treba da ima potpunu sposobnost za rad u skladu sa važećim zakonodavstvom.

Kandidat treba da govori barem jedan od zvaničnih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima.

Kandidat treba da bude sposoban za obavljanje zadatka.

Kandidat ne sme biti osuđivan za krivično delo (potvrda iz suda).

Kandidat ne sme imati na snazi disciplinsku meru zbog teškog prekršaja u javnoj instituciji (potvrda od poslodavca).

Uslovi za učešće u regrutaciji:

Pravo prijave imaju svi građani Republike Kosovo koji su punoletni, imaju potpunu sposobnost za delovanje, završeni odgovarajući nivo obrazovanja i ispunjavaju tražene uslove prema ovom konkursu, kao i profesionalne sposobnosti za obavljanje poslova.

Procedura konkurisanja: Konkurisanje je otvoreno za sve zainteresovane kandidate u skladu sa ovim konkursom.

Rok za prijavu: Konkurs je otvoren od 22.04.2025 do 21.05.2025.

Aplikacije se podnose u navedenom periodu, a rok za dostavu aplikacija je od 22.04.2025 do 21.05.2025.

Predaja prijava: Aplikacije se podnose online na zvaničnom sajtu <https://shskuk.rks-gov.net/>, gde se popunjavaju elektronski (računarom) i dostavljaju u Sektor za ljudske resurse u NCMR – Gjakova.

U prijavi treba jasno navesti instituciju, naziv radnog mesta i broj pozicije. Svi dokumenti i profesionalne potvrde treba da budu priloženi u kopiji, a kandidati koji su završili školovanje van Republike Kosovo treba da imaju nostrifikaciju od Ministarstva obrazovanja, nauke i tehnologije.

Prijave poslate nakon isteka roka ili nepotpune prijave neće biti prihvaćene. Napomena: Svi obaveštenja u vezi sa procedurom konkursa do objave konačnog rezultata biće dostupni na zvaničnom sajtu SHSKUK-a, <https://shskuk.rks-gov.net>.